

5.4 REDAKTIMI I DESTINACIONEVE LOGJIKE

Të gjitha raportet standarde kanë të pëcaktuara destinacionet logjike, të cilat tregojnë destinacionin ku do të dërgohet raporti. P.sh. destinacioni logjik "Printeri – Pasurimi" në modulën COBISS3/Pasurimi përdoret tek dërgimi i porosive, anulimi i tyre, reklamimi...

Çdo përdorues i sistemit mund të ndryshoj vlerat e destinacioneve logjike. Vlera e ndryshuar e destinacioneve logjike shfaqet brenda kllapave rumbullake dhe përdoret në vend të destinacioneve logjike aktuale.

Të dhënat e detajuara për vlerën e paracaktuar të një destinacioni logjik mund t'i shikoni nëse klikoni destinacionin logjik dhe më pas shtypni butonin **I paracaktuar (përshkrimi)**.




Figura 5.4-1: Destinacionet logjike

Procedura

1. Përzgjidhni metodën **Sistemi / Parametrat / Destinacionet logjike**.

Hapet dritarja **Redaktuesi i destinacioneve logjike**. Në pjesën e dritares me mbishkrimin "Destinacionet logjike" shfaqet lista e destinacioneve logjike. Pas emrit të destinacioneve logjike (p.sh. "Etiketa – Inventar") në kllapa të rumbullakëta shfaqet vlera e destinacionit logjik, e cila në bibliotekën e veçantë përcaktohet gjatë instalimit të programit COBISS3 dhe vlenë për të gjithë përdoruesit e sistemit në këtë bibliotekë.

2. Destinacionin e përzgjidhni përmes tasteve për lëvizje <left>, <right> dhe më pas klikoni mbi të
3. Klikoni butonin **Redakto**.
Hapet dritarja **Destinacionet e përdoruesit**, në të cilën redaktoni destinacionin e përzgjedhur logjik (shih kap. 5.3).
4. Klikoni butonin **Në rregull**.

Destinacioni i shtuar shfaqet në kllapa të rumbullakëta.